



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:064350

Datë: 17.06.2019

Numri i dokumentit: 00361247

P.nr.990/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Kaltrina Krasniqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.H nga Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1645/18 të datës 30.10.2018, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 30.05.2019 shpalli publikisht, ndërsa më 17.06.2019 hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **L.H** nga babai B..., e ëma Sh... e lindur P..., i lindur më ... në Gjilan, me vendbanim në Lagja “..., Rr.”...”, nr.19, Komuna e Gjilanit, me numër personal identifikues:, i pa pune, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes ekonomike të varfër, Shqiptar, shtetas i Rep. së Kosovës, më parë i dënuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datë 30.07.2018, rreth orës 05:00 min të mëngjesit, në Lagjen “Dheu i Bardhë” në Gjilan, konkretisht në Rr.”Hasan Tahsini”, në shtëpinë e të dëmtuarit B.R, i pandehuri L.H, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, ka kaluar rrethojën e oborrit, ka hipur mbi kulmin e garazhës së të dëmtuarit, pastaj përmes dritares së katit të parë të shtëpisë, të cilën e ka dëmtuar dhe përmes dritares së katit të dytë depërton në dhomë ku kishte qenë duke fjetur i dëmtuari së bashku me bashkëshorten e tij dhe nga aty ka vjedhur 1 (një) telefon celular të markës Samsung Note 5, me ngjyrë kaltër, pronë e të dëmtuarit, me numër të SIM-kartelës ... si dhe portofolin e të dëmtuarit me 210 Euro para të gatshme, tri kartela bankare dhe dokumentet

personale të cilat i dëmtuari i kishte lënë mbi tavolinë afër dritares, në këtë mënyrë të dëmtuarit B.R i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale, **Vjedhje e rëndë nga neni 327, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,41,45,46,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit **L.H** i shqiptohet **dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, dhe me gjobë prej katërqind (400) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i pandehuri brenda afatit verifikues prej **dy (2) viteve**, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen vepër tjetër penale. Në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri **L.H** obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **njëzet euro (20.00) €**, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari, **B.R nga Komuna e Gjilanit**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 30.10.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1645/18, kundër të pandehurit L.H, për shkak të veprës penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPRK-së. Në shqyrtimin fillestar të datës 30.05.2019, ishin prezent Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu, dhe i pandehuri L.H. Në të cilën seancë i pandehuri L.H pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores së shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit L.H, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehuri nuk ka qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri L.H, ka kryer veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1,1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vjedhje e rëndë konsiderohet:

1 .Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet, nëse:

1.1 vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme;

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtiti ti shqiptohet dënim me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehurit L.H, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se e pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit L.H duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e saj, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

9. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

I pandehuri L.H obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **njëzet euro (20.00) €** në afatin prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Divizioni penal
P.nr. 990/18 më datë 17.06.2019

Sekretarja Juridike
Kaltrina Krasniqi

Gjyqtari
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.